



VENDIM

Nr. 30, Datë 19.11.2012

**PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN
MËSIMORE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i UART në mbledhjen e datës 19.11. 2012, pasi shqyrtoi Vendimin nr. 26, dt. 07.11.2012 të Këshillit të FM dhe pas diskutimeve të anëtarëve dhe propozimeve përkatëse,

VËREN SE

Këshilli i Fakultetit të Muzikës me Vendimin nr. 26, dt. 07.11.2012 i ka propozuar Senatit Akademik një ndryshim në rregulloren e studimit të ciklit të dytë, si më poshtë:

"Neni 3, pika 1.1 e Rregullores së mësimore të ciklit të dytë të studimeve në UART ndryshohet si vijon: "Në seleksionimin e kandidatëve që do të ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve të kenë përparësi kandidatët që kanë mesataren mbi 7.5".

Senati Akademik pasi diskutoi mbi këtë propozim e gjen të paargumentuar këtë propozim të Fakultetit të Muzikës, dhe për këtë arsye

VENDOSI

1. Mos miratimin e propozimit të paraqitur nga Këshilli i Fakultetit të Muzikës me Vendimin nr. 26, datë 07.11.2012.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE